

# KONSULTIMI ME PUBLIKUN

## “ MEDIA PRINT”

EMRI I KOMPANISE : MEDIA PRINT

NIPT: K61313010H

ADRESA: Rruga “ Sabaudin Gabrani ” ish Misto Mame, Kombinat, Tirane

AKTIVITETI: “Perpunim grafik, Printim, Shtypshkronje dhe Shtepi Botuese”

Shtëpia botuese "Mediaprint" është bërë pjesë e ndryshimeve që kanë pësuar politikën arsimore të edukimit që nga viti 2006 në procesin e botimit të teksteve shkollë. Synimi për të realizuar tekste sa më cilësore jo vetëm në përmbajtje por edhe në formë e ka rritur kompaninë tonë duke e çuar drejt përfaqimit të standardeve bashkohore. Partneriteti mes shtëpive botuese dhe autorëve ka bërë që më tepër se 70 autorë tekstesh dhe rreth 100 bashkëpunëtorë të realizojnë botimin e 55 teksteve shkollë dhe 25 fletore pune në ndihmë të nxënësve. Profesore, mesues/e, metodiste, redaktore shkencore, recensente, redaktore gjuhësore e teknike, korrektore, piktoresh, fotografe, grafiste janë një grupim i madh që punojnë për realizimin e këtyre teksteve.

Shtëpia botuese "Mediaprint" nëpërmjet kontakteve të saj me shkollat, duke vlerësuar bashkëpunimin me mesuesit, për gatitje për ta materiale ndihmësi si plane mesimore apo libra mesuesi, si dhe mjete didaktike në ndihmë të procesit mësimor. Ritmi i botimeve të redaksisë i përgjigjet me shumë cilësi e bashkëkohësi në teknologji, shtypshkronja "Mediaprint" e cila disponon makineri të parapërgatitjes, shtypit, libër lidhjes dhe paketimit që sigurojnë proces botimi kualitativ dhe i përgjigjet në kohë të gjitha afatëve të përcaktuara. Bashkëkohësia në teknologjinë e botimeve pasqyrohet me se miri në cilësinë e tyre. Jo vetëm tekstet shkollë por edhe të gjitha botimet e tjera që realizohen në shtypshkronjën tonë garantojnë cilësi të lartë botimi nga një stat teknik inxhinierësh e operatorësh të kualifikuar dhe të specializuar.

### **Shtypshkrimi**

Tashmë, shtypshkronja Mediaprint është bërë lider në shtypin e sheshtë dhe atë rotativ. Makineria e re e shtypit rotativ ka bërë të mundur rritjen me 8 herë të kapaciteteve prodhuese duke ruajtur të njëjtin standard cilësie.





Në shtypin e sheshtë, Mediaprint disponon makineri të llojit Heidelberg, lider në botë për prodhimin e makinerive, e cila mundëson realizimin me cilësi të lartë të një shumëllojshmërie produktesh të shtypit komercial.



## Postshtypi

Procesi i palosjes, prerjes dhe shërbimeve të tjera të postshtypit janë të automatizuara. Kapacitetet e makinerive ecin paralelisht me kapacitetin e shtypit. Kjo gjë mundëson vazhdimësinë e proceseve të punës pa penguar njëra – tjetrën.

Në Mediaprint është e mundur të realizohen edhe një gamë të gjerë printimesh të sigurisë së lartë (shtypi offset, serigrafik, shtyp i lartë), numratorë dixhitalë, adresim, numërim, etj.



## Parapërgatitja

I gjithë procesi i parapërgatitjes së shtypit realizohet nga një staf i specializuar në këtë fushë. Printimi në film apo lastër, kontrolli dixhital i ngjyrave, eksponimi konsiderohen tek ne si një nga proceset më delikate dhe të rëndësishme për një rezultat final cilësor.

### PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE

Me një eksperience të gjatë në fushën e shtypit offset, Media 1Print tashmë ka arritur standartet më të larta. Kjo shtypshkronje, një nga më të mirat në treg, realizon me cilësi të lartë shtypin jo vetëm të librave por dhe të çdo lloji të shtypit komercial si broshura, kataloge, fletpalosje, postera, kalendare, dosje, etj. Teknologjia e përdorur na mundëson realizimin e shtypit në tirazhe të larta, me cilësi dhe në kohë rekord. Në fundmi Mediaprint ka kryer e para dhe e vetmja në Shqipëri investimin gjigand në fushën e shtypit rotativ. Kjo makineri rit ndjeshëm kapacitetin e shtypit. Disa nga makineritë që ne disponojmë janë të renditura si më poshtë: Makineri e shtypit të sheshtë Heidelberg, speedmaster 74p, 4 col

*Makineria e shtypshkrimeve Rotative (KBA)* është makineri ishtypshkrimi e llojit Rotativ, e markës Headsed, Tipi KBA COMPAKTA 214 ME NUMER SERIE 214082. Makina është prodhim gjerman i vitit 1994. Makineria shërben për shtypshkrimin e librave, revistave, gazetave, kartolinave, etj deri në katër ngjyra.

Makineria e realizon shtypshkrimin me metodën rotative, me shtypshkrim të letres rolet në të dy krahet në të njëjtin moment. Ajo ka shpejtësi shtypi deri 50 000 kalime në orë. Realizon procesin që nga shtypshkrimi deri në paketim të produktit. Përbëhet nga arkuesi i bobinës së letres (rotative), katër seksione shtypshkrimi me gjeresi 100 cm secila, seksioni i stabilitetit të punës në moment avarie, furra e tharjes së letres dhe pjekjes së bojës, sistemi i ventilimit dhe i ricklimit të gazrave djegëse, seksioni i ftohjes dhe ngjitjes së letres, seksioni i prerjes, seksioni i palosjes, transportieret, linja me dy prersët për përpunimin e materialit të mbetur, deri në dërgimin për riciklim. Është me panel individual elektrik e drejtim-komandimi dixhital dhe punon në mënyrë automatike. Gjendja e saj është shumë e mirë dhe gati për fillimin e funksionimit.

Makineria e shtypshkrimeve Offset 4 ngjyresh (HEIDELBERG)

Është makine shtypi Offset 4 ngjyresh e markës Heidelberg, Tipi SM 74-4PH, me numer 622923. Makina është prodhim gjerman i vitit 1998. Makineria shërben për shtypshkrimin e librave, revistave, kartolinave, etj deri në katër ngjyra. Është me panel individual elektrik e drejtim-komandimi dixhital dhe punon në mënyrë automatike. Gjendja e saj është shumë e mirë.

### *Tavolinemontimi*

Eshte makineri qe sherben per montimin e firmave dhe te kalkeve gjate pergatitjes se shtypshkrimeve. Eshte ne gjendje te mire pune dhe funksionon normalisht.

### *MakJne qepese me tel (BREHMER)*

Eshte makineri per qepjen me tel te blloqeve, fletoreve etj, gjate pergatitjes se tyre, e markes Brehmer. Makina eshte prodhim gjerman. Eshte ne gjendje te mire pune dhe funksionon normalisht.

### *Thike e njeaneshme (Polar Mohr)*

Eshte paisje qe sherben per prerjen e shtypshkrimeve te ndryshme gjate pergatitjes se tyre, e markes Polar Mohr, model 92EM-MON, me numer serie 6811584. Paisja eshte prodhim gjerman. Eshte ne gjendje te mire pune dhe funksionon normalisht.

### **Thike e njeaneshme (Polar Mohr)**

Eshte paisje qe sherben per prerjen e shtypshkrimeve te ndryshme gjate pergatitjes se tyre, e markes Polar Mohr, model 92EM-MON, me numer serie 6811584. Paisja eshte prodhim gjerman. Eshte ne gjendje te mire pune dhe funksionon normalisht.

### **Makineri paketim (Minipack Junior)**

Eshte makineri qe sherben per paketimin e librave dhe materialeve te tjera te shtypura, e markes Minipack Junior, tipi MF02AA36 dhe numer serie 005259. Makina eshte prodhim italian i vitit 2006. Eshte ne gjendje te mire pune dhe funksionon normalisht.

### **VLERESIMI I NDIKIMEVE DHE MASAT LEHTESUESE**

Cilesia e ajrit		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur
Clirimi i gazeve nga makina Offset	Teknikat e kontrollit paresor te manaxhimit operacional. Respektimi me rigorizitet i kushteve teknike qe do te percaktohen ne kontrolli mujor te tyre si dhe perdorimi i tyre me	Cilesia e ajrit lokal do te jete brenda parametrave te BE- se dhe udhezimeve te OBSH lidhur me mbrojtjen e shendetit publik ne te gjitha vendodhjet perkatese. Si perfundim

	<p>eficence per te shmangur ndotje te pa nevojshme nga mos menaxhimi sic duhet i tyre i mjediseve te punes*psh, lenia ndezur kur nuk eshte e nevojshme.</p> <p>Ne daljen e pluhrave nga kjo makineri jane instaluar thase ne funksion te filtrave per kapjen e pluhrave duke mos lejuar deportimin e tyre ne ambjent</p>	<p>mund te thuhet se gjate funksionimit te kesaj shtypshkronje nuk do te kete ndikime shendetesore tek punonjesit.</p>
Shkarkimi i grimcave nga gjeneratoret	<p>Filtrate ajrit- per zbutjen e pluhurit dhe perqendrimin e gazrave te pasur me squfur nga perdorimi i lendes djegese ne gjeneratoret</p>	<p>Cilesia e ajrit lokal kete zone nuk do te ndikohet dhe do te jete brenda parametrave te BE-se dhe legjis;lacionit ne fuqi</p>

Ujrat siperfaqesore dhe netokesore		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur
Ndikimi nga ujrat urban	Nuk kemi ndikim nga ujrat urban pasi derdhja e tyre behet ne sistemin qendor te zones si dhe tubacionet e perdorura jane ten je cilesie te larte	Asnje
Ndikim ne ujrat siperfaqesore dhe nentokesore	Ne kete nivel ujrash nuk kemi ndikim pasi aktiviteti zhvillohet ne nje ambjent te mbrendshem,I shtruar me dysheme.Aktiviteti nuk ka derdhje te pa kontrolluar te ujrave.	Asnje

Cilesia e tokes		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur

Erozioni i Tokes	Nuk parashikohen ndertime shtese ne kete objekt,nuk do te kemi germime dheu per pasoi nuk do te ndeshemi me fenomenin e erozionit	Asnje
Shkarkimi i ndotesve ne toke nepermjet ujit qe perdoret per veprimtarine, pajisjeve dhe larjes se makinave	Aktivitetet larese do te zhvillohen ne zonate pershtatshme uji i tyre depozitohet ne nje ndares uji /vajra.	Asnje
Shkarkimi/clirimi aksidental i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e ndertimit, gjate magazinimit	Te gjitha zonat e magazinimit do te kene masat e duhura te sigurise mjedisore per te parandaluar shkarkime aksidentale ne toke.	Potenciali per shkarkimet aksidentale te materialeve gjate fazes se magazinimit ne zone do te minimizohet
Shkarkimi/clirimi aksidental i lendeve djegese, vajore, kimike, lendeve te rrezikshme, etj ne toke, vecanerisht ne zonen e ndertimit, gjate transportit per ne vendin e perdorimit	Vendosja e procedurave dhe protokolleve te duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit te materialeve per sa kohe jane ne zonen e zhvillimit	Potenciali per shkarkimet aksidentale te materialeve gjate transportit dhe trajtimit te lendeve brenda zones se zhvillimit do te minimizohet

Trafiku dhe transporti		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur
Trafiku nga mjetet qe do e frekuentojne kete zone nga aktiviteti	Hyrja dhe dalja e automjeteve te shoqerise do te behet nga rruge dytesore. Jane vendosur te gjitha sinjalistikat e nevojshme qe	Asnje

	trgojne hyrjen dhe daljen e automjeteve ne subjekt.	
--	---	--

Zhurma dhe vibrimet		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur
Zhurmat dhe vibrimet nga kryerja e aktivitetit	Ndotja akustike ne kete ambjent eshte e konsiderueshme sidomos kur te gjitha makinerit jane ne pune.Per te ulur nivelin e zhurmes duhet te kryhet pastrim i vazhdueshem i makinerive per te parandaluar defektet.Si dhe ne prodhimin max ku te gjitha makinerite jane ne pune punonjesit duhet te paisen me kufje.	Ulje e nivelit te zhurmes si per punonjesit ashtu edhe per ambientin e jashtem.
Deportimi i zhurmave ne mjedisin e jashtem	Izolim i mire i objektit si dhe mbjellja e pemeve.	Ul deportimin e zhurmave ne ambientin e jashtem.

Ndikimet sociale		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur
Rritja e punesimit( Ndikim pozitiv)	Rekomandimi I masave per shtimin e punesimit dhe permiresimin e kapaciteteve te komunitetit lokal	Kjo eshte ne varesi te te interesuarve

Mbetjet e ngurta		
Ndikimi mjedisor	Masat zbutese	Efekti i mbetur
Menaxhimi i mbetjeve te ngurta	Te gjitha mbetjet e ngurta (letra,karton.)te dala nga ky aktivitet do te paktohen ne kubike dhe do te merren nga komapni te licensuara .	Asnje



--	--	--





